

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**« G.M. ENERGY » Sh.p.k**

Në Durrës, sot më datë 11. 10. 2021 (dymijë e njëzetë e një) :

- 1. Marenglen Emini**, atësia Kahreman, i lindur më 13.10.1979, në Tiranë, dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me nr.personal H91013104G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar; Cel:0692020764, email: [marenglen.emini@gmail.com](mailto:marenglen.emini@gmail.com) ;

Vendosi sa vijon:

**NENI 1**

Themelohet shoqëria tregtare :« **G.M. ENERGY** » shpk.

Ortaku i vetëm themelues i saj është:

**1. Marenglen Emini**

Shoqëria tregtare « **G.M. ENERGY** » do të jetë shoqëri me përgjegjesi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

**NENI 2**

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: “Rruga Lule Bore , Lagjia 13 , Plazh , Durrës, Zona Kadastrale Nr.8518 , Nr.pasurise 39/173-N5”

**NENI 3**

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit. Me vendim të ortakëve, mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë si degë apo përfaqësi edhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**NENI 4**

**Kapitali i shoqërisë**

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 10.000 lekë, formuar nga ortaku themelues, i ndarë në 1 (një) kuotë, zotëruar nga ortaku i vetëm themelues z. Marenglen Emini me vlerë të përgjithshme 10.000 leke dhe përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria mund të ndryshojë kapitalin themeltar; Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë;

Po kështu transferimi i Kuotave bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe përgjithësisht siç parashihet në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve.

Ortakët kanë të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### **NENI 5**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është pa afat.

#### **NENI 6**

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

#### **NENI 7**

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në përputhje me ligjin dhe statutin.

#### **NENI 8**

Shoqëria « **G.M. ENERGY** » Sh.p.k, krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë:

**Import-eksport dhe tregtim me shumice i materialeve elektrike , civile dhe industriale.**

#### **NENI 9**

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarëvajtjen e shoqërisë.

#### **NENI 10**

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

#### **NENI 11**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi me i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i njeh asamblesë së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortakët mund t'ia delegojnë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë.

#### **NENI 12**

Administratori i shoqërisë « **G.M. ENERGY** » Sh.p.k, emërohet:

- 1. Marenglen Emimi**, atësia Kahreman, i lindur më 13.10.1979, në Tiranë, dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me nr.personal H91013104G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar; Cel:0692020764, email: [marenglen.emini@gmail.com](mailto:marenglen.emini@gmail.com) ;

Administratori i shoqërisë, **Marenglen Emini** , emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij akti.

### **NENI 13**

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 kopje origjinale, me të njëjtën vlerë ligjore, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky akti u lexua dhe u kuptua nga nënshkruesi i cili deklaroi se akti është i rregullt tërësisht dhe në çdo paragraf në përputhje me vullnetin e lirë e të plotë të tij,

Nënshkruesi jep pëlqimin për sa përmendet në akt dhe e nënshkruan rregullisht në çdo faqe dhe emër, mbiemër dhe firmë në mbyllje të aktit.

### **ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË TREGTARE**

**“ G.M. ENERGY ” sh.p.k.**

**MARENGLLEN EMINI**

